



INFORMATOR PËR PERSONAT E KTHYER



Ekumenska
Humanitarna
Organizacija



Diakonie
Württemberg





Informatori për personat e kthyer u hartua si njëra prej aktiviteteve që realizohen në kuadër të projektit të Rrjetit për Integrim në Serbi. Projekti është duke u zbatuar nën mbështetjen e Strategjisë së Bashkimit Evropian për Rajonin e Danubit (EUSDR) dhe Diakonia e Virtembergut. Informatori u krijua përmes analizës së kornizës aktuale rregullatore dhe planifikimit të shërbimeve dhe operatorëve në 17 komuna në Serbi, dedikuar për familjet e personave të kthyer sipas Marrëveshjes për Ripranim.

Korrik, 2020

Përmbajtja

HYRJE	4
HAPAT E PARË PAS KTHIMIT NË SERBI	5
AKOMODIMI.....	5
TRANSPORTI.....	6
DOKUMENTET.....	7
FLETËUDHËTIMI	7
LETËRNJOFTIMI.....	7
LIBREZA SHËNDETËSORE	8
ORGANIZATAT, INSTITUCIONET E RËNDËSISHME, TË DREJTAT DHE SHËRBIMET NGA SEKTORË TË NDRYSHËM ...	10
KOMISARIATI PËR REFUGJATË DHE MIGRIM I REPUBLIKËS SË SERBISË (KIRS)	10
KOMUNAT/VETËQEVERISJET LOKALE ..	12
MIRËQENIA SOCIALE	13
ARSIMI	16
PUNËSIMI	18
POLICIA	20
ORGANIZATAT HUMANITARE DHE SHOQATAT E QYTETARËVE	20
INSTITUCIONET MË TË RËNDËSISHME	21
ADRESARI	24



Hyrje

KY INFORMATOR I DEDIKOHET SHTETASVE TË SERBISË QË JANË KTHYER NË SERBI PAS QËNDRIMIT APO PËRPPJEKJES PËR TË HYRË DHE QËNDRUAR NË NJËRIN PREJ VENDEVE TË BE-SË (PARA SË GJITHASH NË GJERMANI) SEPSE NUK PLOTËSOJNË KUSHTET LIGJORE PËR TË QËNDRUAR NË ATË VEND.

INFORMATORI GJITHASHTU MUND TË SHËRBEJË SI UDHËZUES PËRMES TË DREJTAVE DHE SHËRBIMEVE NGA RREZIKSHMËRIA SOCIALE DHE MATERIALE, QOFSHIN ATA TË PËRKATËSISË ETNIKE ROME APO JO-ROME, PERSONA TË KTHYER APO JO TË KTHYER.

Informatori ofron informata rreth:

- Procedurës së ripranimit në bazë së cilës shtetasit e Serbisë kthehen në Serbi.
- Sigurimit të dokumenteve të nevojshëm për të vazhduar qëndrimin në Serbi.
- Të drejtave dhe shërbimeve nga sistemi i mirëqenies sociale, arsimit, shëndetësisë dhe sektorëve tjerë relevantë që i sigurojnë mbështetje personave të kthyer dhe personave në rrezik nga cenueshmëria sociale dhe materiale.
- Institucioneve, organizatave dhe operatorëve për ofrimin e shërbimeve në 17 komuna në Serbi, që janë relevante në raport me nevojat e personave të kthyer nga ripranimi, që me qëllim të sigurimit të mbështetjes praktike për (ri) integrimin e familjeve që janë kthyer vullnetarisht apo me forcë nga RF e Gjermanisë në Serbi.

Procedura e ripranimit

Ripranimi - Fjala ripranim do të thotë pranim i sërishëm. Ripranimi është procedura e kthimit të personave nga vendi në të cilin nuk i plotësojnë (më) kushtet për të qëndruar apo hyrë në atë vend dhe procedura e pranimit në vendin në të cilin kthehen, dhe shtetas të cilit janë.

Marrëveshjet për ripranim janë marrëveshje ndërkombëtare që rregullojnë procedurën e kthimit dhe pranimit të personave që nuk plotësojnë apo nuk plotësojnë më kushtet për të hyrë apo qëndruar në territorin e shtetit tjetër. Serbia ka nënshkruar në vitin 2007 marrëveshjet për ripranim me Bashkimin Evropian dhe anëtarët e tij individuale, duke përfshirë Gjermaninë.

Personi i kthyer në bazë të marrëveshjes për ripranim është personi i cili kthehet, përkatësisht merret, dhe është përcaktuar që është shtetas i njëjës prej palëve nënshkruese.

Kërkesa për ripranim: Vendi anëtar i BE-së mund të identifikojë personin i cili nuk plotëson apo nuk plotëson më kushtet e zbatueshme për hyrje, qëndrim apo vendosje në territorin e tij. Nëse ka prova që ky person është shtetas i Serbisë ky shtet i drejtohet misionit kompetent diplomatik apo përfaqësisë konsullore të Serbisë në këtë vend me Kërkesën për ripranim.

HAPAT E PARË PAS KTHIMIT NË SERBI

/akomodimi

Nëse pas kthimit në Serbi nuk keni akomodim të siguar dhe nuk keni gjetur mundësinë për qëndrim të përkohshëm tek një i afërm apo mik, mund të akomodoheni në Qendrën për pranim ndërhyrës, e cila është e dedikuar për akomodim të familjeve më të rrezikuara të kthyer apo në strehimore.

1. Qendra për pranim ndërhyrës e Komisarariatit për refugjatë të Republikës së Serbisë

- Akomodimi realizohet në bazë të Udhëzimit që e lëshon Komisarati për refugjatë i Republikës së Serbisë.
- Qendra për pranim ndërhyrës gjendet në Bela Palanka. Në Qendër është siguar akomodimi dhe ushqimi (mëngjesi, dreka dhe darka) dhe nevojat tjera elementare të jetesës.
- Ju keni në dispozicion të gjitha informatat dhe këshillat e nevojshme rreth të drejtave, obligimeve dhe mundësive, si dhe ndihmën për fillimin e procesit të sigurimit të dokumentacionit dhe ndërmjetësimit tek shërbimet kompetente.
- Në Qendër mund të qëndroni më së shumti 14 ditë.

2. Strehimorja

Strehimorja është akomodimi i përkohshëm të cilin e siguron Qendra për Punë Sociale.

Ju duhet të kontaktoni Qendrën për Punë Sociale në komunën në të cilën keni vendbanimin apo në vendin ku jeni gjendur pas kthimit në vend, nëse nuk keni vendbanim. Qendra për Punë Sociale lëshon vendim për akomodimin e personave në strehimore, e cila mund të zgjasë deri në skadimin e afatit të vlefshmërisë së Fletudhëtimit.

Shërbimet që i sigurohen strehimores kanë të bëjnë me plotësimin e nevojave elementare për bujtje, ushqim, higjienë dhe mbrojtje shëndetësore elementare.

Ekzistojnë strehimore të ndryshme (për fëmijë, për të rritur, për nëna me fëmijë deri në moshë një vjeç). Duhet të dini që nuk ekzistojnë strehimore ku mund të akomodohen anëtarët e familjes së bashku.



3. Akomodimi në hapësirën e banimit e cila është shfrytëzuar para shkuarjes jashtë shtetit

Nëse personi i kthyer/familja e personit të kthyer kthehet në hapësirën e vet të banimit/jetesës, e cila është shkatërruar, nuk ka kushte, personi i kthyer duhet t'i drejtohet Shërbimit për Veprimtari Shoqërore në komunën e tij dhe të informohet rreth këtyre mundësive:

- Rreth ekzistimit të banimit social dhe banesave sociale, e nëse ato ekzistojnë, rreth kushteve të konkurrimit për realizimin e të drejtave për shfrytëzimin e banesës sociale;
- Rreth asaj nëse ekzistojnë mjete (fonde) të planifikuara për ndarjen e mjeteve për përmirësimin e kushteve të banimit në material ndërtimor për personat e rrezikuar social;
- Rreth asaj nëse ekzistojnë kredi të vendosura të subvencionuara për avancimin e kushteve të banimit nën standarde;

Disa vetëqeverisje lokale nuk kanë zhvilluar këto programe të mbështetjes, por në këto raste Komuna, përmes Vendimit të saj për të drejtat e mirëqenies sociale, ka mjete të parapara për ndihmë të njëhershme, dhe disa edhe për rritje të ndihmave të njëhershme, me të cilat personat në nevojë, mundën që përmes Qendrës për Punë Sociale kompetente, nën kushtet dhe lartësinë e paraparë nga komuna, të realizojnë këto ndihma në të holla me qëllim të avancimit të kushteve të banimit.

Personi i kthyer mund t'i drejtohet për informata rreth mbështetjes dhe banimit edhe Komisarit për refugjatë dhe migrim apo Koordinatorit rom në komunën e tij.

/transporti

Çfarë të bëni nëse keni hyrë në Serbi dhe nuk keni të holla për të udhëtuar deri në vendbanim apo në vendin e qëndrimit?

Nëse jeni të akomoduar në Qendrën për pranim ndërhyrës, Qendra ju siguron transportin deri tek mjedisi pritës pas skadimit të afatit të strehimit urgjent.

Në rastet tjera, vërtetimin për biletë pa pagesë në një drejtim deri tek destinacioni i dëshiruar mund ta merrni në Qendrën për Punë Sociale në vendin ku gjendeni. Në Beograd këtë vërtetim mund ta merrni në Qendrën për Punë Sociale të qytetit në rr. Lomina nr. 17 (tel. 011 3614 332).



DOKUMENTET

1. FLETUDHËTIMI

Fletudhëtimi është dokumenti juaj i obligueshëm i udhëtimit pas hyrjes në Serbi, ruajeni me kujdes!

Fletudhëtimi është dokument i udhëtimit, i cili i lëshohet shtetasit të Republikës së Serbisë, i cili gjendet jashtë shtetit pa dokument udhëtimi, me qëllim të kthimit në Republikën e Serbisë. Fletudhëtimi lëshohet me afat të vlefshmërisë prej së paku 3 muaj nga dita e lëshimit. Fletudhëtimin e lëshon përfaqësia diplomatike apo konsullore e Republikës së Serbisë, në territorin e së cilës është gjendur shtetasi i Republikës së Serbisë, i cili është jashtë shtetit pa dokument udhëtimi.

Nëse e keni humbur Fletudhëtimin, ju jeni i obliguar që humbjen ta lajmëroni në stacionin më të afërt policor, për t'ju lëshuar **vërtetimin** për humbjen e Fletudhëtimit, i cili do t'ju shërbejë si zëvendësim.

Nëse Fletudhëtimi është dokumenti i vetëm që e posedoni, në bazë të Fletudhëtimit mund të realizoni qasjen në të drejtat e mëposhtme:

- identifikimi personal,
- ndihma mjekësore urgjente,
- adresimi në Qendër për Punë Sociale,
- fillimi i procesit të regjistrimit të fëmijëve në shkollë fillore dhe të mesme.

Duke marr parasysh që Fletudhëtimi është dokument i përkohshëm, duhet që sa më shpejtë të filloni procesin e marrjes së **letërnjoftimit**, dhe më pas edhe të dokumenteve tjerë. Kur të merrni dokumentet kryesore, do të realizoni të drejtat tuaja nën kushte të njëjta si edhe shtetasit tjerë të RS-së.

2. LETËRNJOFTIM

Kur keni letërnjoftimin, keni dokumentin fillestar i cili është i domosdoshëm për të siguruar dokumentet tjera personale dhe realizimin e të drejtave dhe shërbimeve.

Letërnjoftimi është dokument publik përmes së cilit shtetasit e Republikës së Serbisë dëshmojnë identitetin. Shtetasi më i vjetër se 16 vjet, i cili ka **vendbanim** në territorin e Republikës së Serbisë, është i obliguar që të ketë letërnjoftim. Letërnjoftimi lëshohet me kërkesë personale në stacionin lokal policor. Për fëmijën, përkatësisht personin që është i privuar nga aftësia për punë, kërkesën për lëshimin e letërnjoftimit e paraqet prindi apo përfaqësuesi tjetër ligjor (së bashku me pëlqimin me shkrim të prindit tjetër).

Gjatë paraqitjes së Kërkesës për lëshimin e letërnjoftimit, paraqitësit i lëshohet një vërtetim i cili shërben si dëshmi rreth kërkesës së paraqitur.

Vendbanimi

Vendbanimi është vendi në të cilin keni qenë i regjistruar para shkuarjes jashtë shtetit dhe në të cilin planifikoni që, pas ardhjes në Republikën e Serbisë, të vendoseni përgjithmonë në një periudhë të gjatë kohore.

Nëse nuk keni vendbanim të regjistruar, duhet të provoni që me mbështetjen e të afërmeve dhe miqve të siguron adresën ku do të regjistroheni, e cila do të



jetë adresa e juaj e ardhshme në letërnjoftim.

Gjithashtu, ekziston mundësia e paraqitjes së vendbanimit në adresën e Qendrës për Punë Sociale: personi i cili dëshiron të paraqesë vendbanimin në adresën e Qendrës për Punë Sociale, në territorin e të cilit gjendet, së pari i drejtohet Qendrës për Punë Sociale për të marrë pëlqimin me shkrim për paraqitje të vendbanimit në adresën e Qendrës për Punë Sociale. Pëlqimi është pjesë përbërëse e formularit¹ për paraqitjen e vendbanimit, i cili më pas i paraqitet organit kompetent të punëve të brendshme, i cili përcakton nëse janë përmbushur kushtet për paraqitjen e vendbanimit dhe në varësi prej gjendjes faktike të përcaktuar, lëshon një vendim rreth kërkesës së paraqitur.

3. LIBREZA SHËNDETËSORE

Personat e kthyer janë shtetas të Republikës së Serbisë të cilët në bazë të dokumenteve personale realizojnë të drejtën për mbrojtje shëndetësore sipas Ligjit për Sigurim Shëndetësor dhe Rregullores për mënyrën dhe procedurën e përcaktimit të drejtave nga sigurimi i obligueshëm shëndetësor. Obligimi i aplikimit për sigurim shëndetësor është në afat prej 30 ditësh, e më së shumti 60 ditë pas kthimit.

Për të marrë librezën shëndetësore ju duhet të keni:

- Dokumentin e identifikimit (letërnjoftimin apo pasaportën, certifikatën nga libri amë i të lindurve).
- Vërtetimin mbi aplikimin për vendbanim, përkatësisht për vendqëndrim (Të siguruarit që kanë letërnjoftim, nuk janë të obliguar që së bashku me kërkesën të dorëzojnë edhe aplikacionin për vendbanim).
- Sipas nevojës dokumentet tjera për personat nga grupet e ndjeshme.



¹ <http://www.pravno-informacioni-sistem.rs/SIGlasnikPortal/eli/rep/sgrs/ministarstva/pravilnik/2012/113/1/reg>





ORGANIZATAT, INSTITUCIONET E RËNDËSISHME, TË DREJTAT DHE SHËRBIMET NGA SEKTORË TË NDRYSHËM

Komisariati për refugjatë dhe migrim i Republikës së Serbisë (KIRS)

institucioni kryesor për çështjet
e personave të kthyer në Serbi
- dyert e para në të cilat trokitni-

Selia e Komisaritit për refugjatë dhe migrim të Republikës së Serbisë është në Beograd, ndërsa personave të kthyer mbështetje të drejtpërdrejt i siguron përmes Zyrës për refugjatë/Këshillit për migrim, që gjenden në secilën vetëqeverisje lokale dhe përmes Zyrës për Ripranim e cila gjendet në aeroportin Nikola Tesla.

Zyra për ripranim

(në aeroportin Nikola Tesla)

Nëse jeni kthyer në Serbi me aeroplan, është shumë e rëndësishme që menjëherë pas ardhjes të kontaktoni Zyrën për Ripranim në aeroportin Nikola Tesla në Beograd.

Zyra mundëson:

- informimin e personave të kthyer lidhur me të drejtat dhe obligimet e tyre, dhënien e këshillave.
- pranimin primar dhe urgjent.
- transportin e personit të kthyer deri tek qendra për pranim ndërhyrës të Komisaritit për refugjatë dhe migrim.
- informimin e personave të kthyer rreth veprimeve të para që duhet ndërmarrë për të marrë dokumentet.
- drejton këta persona tek Zyrat/Këshillat për migrim dhe shërbimet tjera në vetëqeverisjet lokale për ndihmë të mëtutjeshme.

Në këtë Zyrë mund të merrni edhe “Informatorin për personat e kthyer pas ripranimit” i shtypur në pesë gjuhë: në gjuhën serbe, rome, angleze, gjermane dhe holandeze².

Në Zyrë ju mundësohet kontakti me familjen dhe miqtë të cilët ju presin.

Në Zyrën për Ripranim ju duhet të regjistroheni si person i kthyer. Pyetësori mbushet në hapësirat e Zyrës për Ripranim. Regjistrimi në Zyrën për Ripranim është vullnetar dhe është e rëndësishme të dini që regjistrimi në institucionin kompetent lehtëson procesin e realizimit të drejtave dhe integrimin, dhe nuk do të thotë që do t’ju ndodh diçka e keqe.

VARËSISHT PREJ ASAJ NËSE KENI ARDHUR PËRMES RRUGËVE AJRORE APO TOKËSORE DHE NË CILIN QYTET JENI NDALUR, SË PARI KONTAKTONI KËTO SHËRBIME!!!

Zyrat/këshillat për migrim pranë komunave / vetëqeverisjeve lokale

Nëse nuk keni kontaktuar Zyrën për Ripranim në aeroport, apo keni hyrë në territorin e RS-së përmes njërit prej vendkalimeve kufitare në rripin tokësor të kufirit shtetëror, duhet t’i drejtoheni për ndihmë Komisarariatit për refugjatë dhe migrim si dhe Këshillit për migrim, lokalet e të cilave ndodhen në ndërtesën e komunës, në të cilën planifikoni që të vendoseni përkohësisht apo përgjithmonë.

Ata do t’ju ofrojnë ndihmën e parë dhe është e rëndësishme që të jeni në kontakt të vazhdueshëm me këto shërbime në mënyrë që të jeni i informuar me kohë rreth programeve të mbështetjes dhe ndihmës për personat e kthyer në bazë të Marrëveshjes për Ripranim.

² <http://www.kirs.gov.rs/media/uploads/Readmisija/Informatori/Informator%20za%20povratnike%20po%20osnovu%20sporazuma%20o%20readmisiji.pdf>



Komunat/ vetëqeverisjet lokale



**SHIHNI NËSE KOMUNA
JUAJ KA EKIP MOBIL, SI T'I
KONTAKTONI ATA!
SHIHNI NË KËTË
BROSHURË CILAT
SHËRBIME KA KOMUNA
NË TË CILËN JENI DUKE
QËNDRUAR AKTUALISHT.**

Çdo komunë ka **divizionin për veprimtari shoqërore apo divizionin për administratë të përgjithshme**. Në komuna më të vogla mund të ndodh që ky shërbim i vetëm të ofrojë shumicën e shërbimeve dhe të sigurojë shumicën e informacioneve që mund të jenë të rëndësishme për personat e kthyer:

- përfitimet për shtesat fëmijërore, shtesat prindërore dhe përfitimet tjera materiale,
- shërbimet e ofrimit të ndihmës juridike qytetarëve,
- shërbimet e Qendrës së Asistencës (vërtetimi i nënshkrimit, dorëshkrimit dhe kopjeve të dokumenteve, dhënia e informacioneve për palët, pranimi dhe evidentimi i parashtresave ...)
- shërbimet e Komisarariatit për refugjatë etj.

Në komunë ekziston edhe **Shërbimi i ofiqarisë** ku do të merrni certifikatat nga libri amë i të lindurve dhe nga libri i nënshtetësisë për rregullimin e dokumenteve tjera personale.

Në komuna më të mëdha mund të ekzistojnë edhe shërbime tjera që mund të jenë të dobishme: **departamenti për ndihmë juridike, mbrojtësi i qytetarëve, këshilltari për të drejtat e pacientëve** etj.

Në ndërtesën e komunës është edhe selia e Zyrës/Këshillit për migrim.

Në ndërtesën e komunës kryesisht gjenden edhe koordinatori për çështje të romëve dhe personi kontaktues për ekipin mobil, nëse komuna e ka një të tillë.

Koordinatori për çështje të romëve

Një numër i madh i komunave në Serbi kanë koordinatorët për çështje të romëve, të cilët janë përgjegjës që vetëqeverisjeve lokale t'i ofrojnë mbështetje në zbatimin e Strategjisë për përfshirje sociale të romëve dhe romëve në nivel lokal. Ata punojnë në avancimin e bashkëpunimit dhe ndërlidhjes së institucioneve të ndryshme në nivel lokal për zgjidhjen më të shpejtë dhe më të mirë të problemeve të komunitetit rom, organizojnë takimet e tyre, lehtësojnë komunikimin dhe bashkëpunimin. Pra, puna e tyre është më pak e përqendruar në ofrimin e mbështetjes për individë, por natyrisht është e rëndësishme të dini kush është dhe ku gjendet në komunë koordinatori për çështje të romëve, nëse ballafaqoheni me mëdyshje dhe probleme në zgjidhjen e situatës suaj si person i kthyer.

Ekipet mobile për përfshirjen e romëve

Në nivel të komunave/qyteteve janë duke u themeluar ekipet mobile për përfshirjen e romëve, dhe akoma nuk i kanë secila komunë në Serbi. Anëtarët/et e ekipeve mobile organizojnë vizita të përbashkëta në terren në lagjet e romëve dhe së bashku ofrojnë mbështetje dhe ndihmë për individët dhe familjet. Anëtarët/et e ekipeve mobile janë: koordinatori/ja për çështje të romëve, i angazhuar në administratën e komunës/qytetit, asistenti/ja pedagogjike, ndërmjetësuesi/ja shëndetësore, përfaqësuesi/ja i Qendrës për Punë Sociale, dhe përfaqësuesi/ja e filialit të Shërbimit Kombëtar për Punësim.

Mirëqenia sociale

Qendra për Punë Sociale (QPS) është një institucion i mirëqenies sociale të cilin e ka çdo komunë. QPS është vendi i parë të cilit i drejtoheni lidhur me të drejtat dhe shërbimet nga kjo fushë. Qendra për Punë Sociale siguron:

- biletën pa pagesë deri në vendin e vendbanimit në një drejtim në qendrën për punë sociale të qytetit.
- akomodim të përkohshëm – qendra për punë sociale lëshon vendim lidhur me akomodimin e personave në strehimore, i cili mund të zgjasë deri në skadimin e afatit të vlefshmërisë së Fletudhëtimin.



Nëse jeni banor i komunës ku keni regjistruar vendbanimin, mund që përmes Qendrës për Punë Sociale amë të realizoni edhe këto:

- ndihmë sociale në të holla, për familjen (apo individin) sipas kushteve të parapara,
- ndihmë të njëhershme në të holla apo lloje tjera ndihmesh, në përputhje me vendimin e vetëqeverisjes lokale lidhur me të drejtat nga mirëqenia sociale,
- të drejtën për shfrytëzimin e Kuzhinës Popullore – një shujtë ditore për popullatën e rrezikuar – në vendet ku ato ekzistojnë,
- punë këshillëdhënëse dhe ndërmjetësim,
- të drejtën për shfrytëzimin e shërbimeve lokale të mirëqenies sociale, sipas kushteve të parapara në përputhje me nevojat për shërbimet që Qendra për Punë Sociale i vlerëson. Disa prej shërbimeve lokale janë: ndihma në shtëpi për persona të rritur dhe të moshuar, përcjellësi personal i fëmijës, asistenti personal, qëndrimi ditor për fëmijët dhe të rriturit me invaliditet, strehimorja, bujtina dhe të tjera.

Në Qendrën për Punë Sociale mund të merrni dhe shumë informacione tjera të nevojshme për të plotësuar nevojat tuaja të ndryshme dhe zgjidhjen e vështirësive të ndryshme që keni!

Mbrojtja shëndetësore

Filiali i Entit Republikan për Sigurim Shëndetësor

Baza për realizimin e të drejtave në shërbime dhe mbrojtje shëndetësore për të gjithë qytetarët (për të punësuarit, të papunësuarit, shfrytëzuesit e ndihmës sociale, bujqit dhe të ngjashëm) përcaktohet në filialin e Fondit Republikan për Sigurim Shëndetësor (FRSSH), sipas vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimit.

Personat e përkatësisë etnike rome³, të cilët nuk e

kanë të rregulluar vendbanimin/vendqëndrimin, mund të marrin librezën shëndetësore në bazë të deklaratës që janë pjesëtarë të përkatësisë etnike rome dhe deklaratës mbi vendbanimin faktik.

FRSSH lëshon një **vërtetim të sigurimit shëndetësor** me të cilin realizoni të drejtat nga sigurimi shëndetësor i obliguar, deri në marrjen e kartelës (e ashtuquajtura librezë shëndetësore).

Në bazë të sigurimit shëndetësor, anëtarët e familjes të personit të siguruar mund të realizojnë **të drejtën në sigurim shëndetësor**.

³ Neni 16, paragrafi 11 i Ligjit për sigurim shëndetësor: Personat që nuk plotësojnë kushtet për përfitimin e statusit të personit të siguruar nga neni 11 i këtij Ligji, dhe të cilët nuk plotësojnë kushtet që të jenë të siguruar si anëtarë të familjes konsiderohen të siguruar në kuptim të këtij Ligji edhe atë: neni 11 – personat e përkatësisë etnike rome, të cilët për shkak të mënyrës tradicionale të jetesës nuk kanë vendbanim, përkatësisht vendqëndrim në Republikën e Serbisë.

Shtëpia e Shëndetit

Në rast të sëmundjes, mbrojtjen shëndetësore e realizoni në Shtëpinë e Shëndetit, me dokumentin e rregulluar shëndetësor (kartelën apo vërtetimin - deri në rregullimin e dokumenteve personale). Shtëpitë e Shëndetit të një komune, kanë edhe Shtëpitë e Shëndetit më të vogla apo Ambulancat në vendet që i takojnë asaj komune, kështu që gjithmonë mund të paraqiteni në institucionin më të afërt shëndetësor.

Personit të siguruar i sigurohet e drejta në zgjedhjen e lirë të institucionit shëndetësor dhe zgjedhja e lirë e mjekut (në tekstin e mëtejme: mjeku i zgjedhur). Çdo individ është i obliguar që të ketë mjekun e zgjedhur, nëse mbrojtjen shëndetësore e realizon në institucione shtetërore, e jo në ofruesit privat të shërbimeve shëndetësore. Mjeku i zgjedhur është:

- (1) doktor i mjekësisë apo doktor i mjekësisë specialist në fushën e mjekësisë së përgjithshme, përkatësisht specialist i mjekësisë së punës.
- (2) doktor i mjekësisë, specialist i pediatriisë,
- (3) doktor i mjekësisë, specialist i gjinekologjisë,
- (4) doktor i stomatologjisë.

Personi i siguruar mund të ketë vetëm një mjek të zgjedhur nga degët e mjekësisë që janë të cekura këtu.

Nëse keni ndonjë vështirësi në realizimin e të drejtave në mbrojtje shëndetësore, mund të drejtoheni tek **Këshilli për të drejtat e pacientëve**, i cili e ka selinë në Komunë.

Arsimi

Njëra prej detyrave të para që duhet të bëni pas kthimit në Serbi është regjistrimi i fëmijëve në shkollë.

Arsimi i obligueshëm në Serbi është falas, zgjat 9 vjet dhe ai përbëhet nga: Programi përgatitor parashkollor (PPP) për fëmijët e moshës 5,5-6,5 vjet dhe shkolla fillore tetëvjeçare (6,5-15 vjet).

Çfarë do të bëni nëse fëmija juaj është në moshën shkollore dhe nëse ndonjëherë prej klasave e ka kryer në shtetin në të cilin keni qëndruar para kthimit?

Për të regjistruar fëmijën në klasën përkatëse të shkollës fillore apo të mesme në Serbi duhet që të nostrifikoni dokumentet e tij/saj shkollore nga jashtë shtetit. **Nostrifikimi** është pranimi i dokumenteve të huaja të shkollës fillore, shkollës së mesme dhe shkollës së lartë.

Nostrifikimi kryhet në **Agjencinë për Kualifikim të Republikës së Serbisë**, në qendrën ENIC/NARIC, e cila gjendet në Majke Jevrosime 51 në Beograd. Nga faqja e internetit të Agjencisë për Kualifikim mund të merrni Kërkesën për pranimin e dokumenteve shkollore të huaja. Me këtë kërkesë dorëzoni edhe dokumentacionin e nevojshëm. Kërkesën dhe dokumentacionin e dërgoni me postë të rekomanduar apo e dorëzoni personalisht në shkrimoren e Agjencisë për Kualifikim.



Dokumentacioni i nevojshëm për pranimin e dokumenteve të huaja të shkollës fillore:

1. Dëftesa origjinale mbi përfundimin e klasës së fundit të shkollës fillore jashtë shtetit apo në një institucion të huaj në Republikën e Serbisë, përkatësisht dëftesa origjinale mbi përfundimin e shkollës fillore, e cila, nëse është e nevojshme⁴, duhet të jetë e vërtetuar me vulë "Apostille" nga ana e organit kompetent në vendin ku është lëshuar dokumenti dhe fotokopja e të njëjtit.
2. Përkthimi i dëftesës të klasës së fundit të përfunduar, e përkthyer nga përkthyesi i autorizuar i gjykatës në Republikën e Serbisë (dy kopje) dhe fotokopja e të njëjtit.

Vërejtje:

- Të dyja kopjet e përkthimit të dëftesës duhet të jenë të vërtetuara me vulë origjinale të përkthyesit të autorizuar të gjykatës, i cili është i obliguar me ligj, që palës t'i lëshojë dy kopje.
- Përkthimi i dokumenteve nuk është i nevojshëm për dokumentet e lëshuara në Mal të Zi, Republikën e Kroacisë dhe në Bosnje e Hercegovinë.

3. Dëshmi rreth përfundimit më herët të klasave në Republikën e Serbisë apo jashtë shtetit (dëshmia origjinale mbi përfundimin e klasës së fundit dhe nga një fotokopje të përfundimit më herët të gjithë klasave).
4. Dëshmi mbi pagesën e taksës – Dëshmi mbi pagesën e taksës për shpenzimet e procedurës së pranimin të dokumenteve shkollë të huaja për arsim fillor në dobi të Agjencisë për Kualifikim (në llogarinë rrjedhëse e cila është cekur të dokumentin Fletëpagesa).

⁴ Vërtetimi i diplomës origjinale me vulë

Apostille nuk është i nevojshëm nëse

diploma është marrë në vendet me të cilët

Republika e Serbisë ka marrëveshje të

nënshkuara bilaterale për lirin e ndërsjellë

të dokumenteve publike. Më shumë detaje në

<http://azk.gov.rs/Biblioteka/Centri/Enicnarc/>

Uputstvo-V.pdf

KËRKONI NË VENDIN KU JENI VENDOSUR NËSE NDONJË ORGANIZATË HUMANITARE NDOHTA MUND T'JU NDIHMOJË NË PROCESIN E NOSTRIFIKIMIT.

Taksa nuk paguhet për nxënësit, prindërit e të cilëve janë të papunësuar që statusin e tyre e dëshmojnë përmes vërtetimit nga filiali i Shërbimit Kombëtar për Punësim, të cilin e dorëzojnë me dokumentacionin tjetër.

Regjistrimi në Programin përgatitor parashkollor dhe në klasën e parë: Fëmijët nga grupet e ndjeshme shoqërore, në të cilat hyjnë edhe personat e kthyer, mund të regjistrohen në Programin përgatitor parashkollor dhe në klasë të parë vetëm me dëshmitë e dorëzuara mbi kontrollimin shëndetësor të fëmijës, pa dokumente tjera të obligueshme që janë të parapara me ligj.

Sipas Ligjit për arsim dhe edukim parashkollor, fëmijët e personave të kthyer trajtohen si grup i ndjeshëm dhe kanë prioritet me rastin e regjistrimit në **ente parashkollore** shtetërore. Gjithashtu, nëse keni realizuar të drejtën për ndihmë sociale në të holla, mund të realizoni edhe të drejtën në kompensimin e shpenzimeve të qëndrimit në ent parashkollor. Disa ente parashkollore kanë edhe programe të veçanta për fëmijët e moshës parashkollore të cilët nuk janë të regjistruar në ent parashkollor.

SHIHNI NËSE ENTI PARASHKOLLOR NË KOMUNËN KU JENI VENDOSUR KA PROGRAME TË KËTILLA!

Të drejtat dhe mbështetja që shkolla siguron për të gjithë apo për kategori të caktuara të nxënësve: qëndrim i zgjatur në shkollë fillore për fëmijët deri në klasën e katërt, librat shkollorë falas për nx-

ënësit e shkollës fillore, transporti falas, programet e mbështetjes në mësimnxënie, plani individual arsimor për nxënësit me pengesa në zhvillim etj. Personat e kthyer nuk janë mjaftueshëm të njohur si grup specifik i cenueshëm në procesin e arsimit, kështu që të drejtat dhe mbështetja e cekur, kryesisht kanë të bëjnë ose për të gjithë nxënësit ose për nxënësit nga familjet që janë të rrezikuara sociale dhe materiale, më së shpeshti shfrytëzuesit e ndihmës sociale në të holla dhe fëmijët me pengesa në zhvillim.

SHQYRTONI NËSE EDHE FËMIJA JUAJ KA NEVOJË PËR NDONJËRËN PREJ KËTYRE MBËSHTETJEVE DHE MUND T'I REALIZOJË ATO!

Asistenti pedagogjik për fëmijët dhe nxënësit e përkatësisë etnike rome mund të angazhohet në ent parashkollor, në shkollë fillore dhe të mesme të cilat kanë numër të madh të fëmijëve të përkatësisë etnike rome. Asistenti pedagogjik paraqet mbështetje për grupin e fëmijëve në shkollë (jo për një fëmijë individualisht), si dhe për arsimtarët që punojnë me fëmijët. Ai është edhe një lidhje e rëndësishme ndërmjet shkollës dhe familjes së fëmijës. Për personat e kthyer të komunitetit rom mund të jetë shumë e rëndësishme mbështetja në integrim nëse institucioni në të cilin fëmija mëson apo e ndjek ka asistent pedagogjik.

SHIHNI NËSE NË RRETHIN TUAJ KOPSHTI I FËMIJËVE APO NDONJËRA PREJ SHKOLLAVE KANË TË ANGAZHUAR ASISTENTIN PEDAGOCJIK.

Punësimi

**SHËRBIMI KOMBËTAR PËR PUNËSIM
KRYEN PUNËT E PUNËSIMIT, E PËR
TË KRYER KËTO PUNË SHËRBIMI
KOMBËTAR FORMON FILIALET E TIJ,
QË KRYEJNË PUNËT E BESUARA PËR
KOMUNITETET LOKALE.**

Përveç Shërbimit Kombëtar, punët e punësimi i kryejnë edhe **agjencitë për punësim**, të cilat veprojnë në komunitetet lokale dhe të cilat duhet të kenë lejen e vlefshme për punë. Shërbimet Kombëtare mund që agjencive për punësim t'i besojnë disa prej punëve të tyre.

Nëse jeni duke kërkuar punë, mund t'i drejtoheni Shërbimit Kombëtar - filialit që është përgjegjës për komunitetin tuaj lokal, dhe/ose Agjencisë për punësim.

I papunësuar paraqitet në Shërbimin Kombëtar/Agjencinë për punësim me letërnjoftim dhe diplomë të shkollës, klasës që e ka përfunduar.

I papunësuar që është paraqitur mund që përmes internetit të jetë në kontakt me SHKP-në, të aplikojë për punë, të shqyrtojë ofertat dhe shpalljet, në atë mënyrë që në **udhëzimet për përdoruesit** në sajtin e SHKP-së, ndjek udhëzimet teknike për kandidatët dhe kështu përdor shërbimet e SHKP-së.⁵

⁵ http://www.nsz.gov.rs/live/digitalAssets/0/435_tehnicko_uputstvo_-_kandidat.pdf



Pas aplikimit në Shërbimin Kombëtar për Punësim, shërbimi, përkatësisht këshilltari për punësim dhe i papunësuarit e kanë për obligim që të hartojnë planin individual për punësim, të cilin janë të obliguar ta respektojnë edhe shërbimi edhe i papunësuarit. Aplikimi në Shërbimin për Punësim është kusht që në qendrën kompetente për punë sociale të mund të përfitoni ndihmën sociale në të holla.

Shërbimi është i obliguar që të:

- Njoftojë të papunësuarin rreth mundësive dhe kushteve për punësim.
- Ndërmjetësojë në punësim.
- Krijojë masat aktive të politikave të punësimit.
- Zbatojë orientimin dhe këshillimin profesional rreth planifikimit të karrierës.

Shërbimi për Punësim mund që përmes masave të politikës aktive, të ofrojë:

- Subvencione për punësim,
- Mbështetje për vetëpunësim/mjete fillestare të filloni biznesin tuaj,
- Arsimim dhe trajnime shtesë.
- Organizojë punë publike, ku mund t'ju angazhojë dhe mundësojë një pagë.

I papunësuarit që realizon të drejtën në ndihmë sociale në të holla, në përputhje me ligjin, ka të drejtë **në kompensimin e shpenzimeve të dërgimit të aplikacionit dhe kompensimin e shpenzimeve të transportit publik për qëllime të intervistës për punë me punëdhënësin.**

I papunësuarit është i obliguar që:

- të respektojë obligimet e tij nga plani individual i punësimit,
- edhe vetë në mënyrë aktive të kërkojë punë dhe t'i drejtohet për punësim vetë punëdhënësit,
- të mos refuzojë punësimin e ofruar përkatës, apo arsimimin ose trajnimin, në përputhje me planin individual të punësimit,
- një herë në tre muaj të paraqitet tek këshilltari për punësim,
- të njoftojë shërbimin për çdo ndryshim i cili është relevant për punësim (për shembull rreth punësimit të gjetur në mënyrë të pavarur ...).

Aplikimi në Agjencinë për punësim, nëse ekziston një e tillë në komunën tuaj, është i dobishëm sepse ai mund merret me punësimin e atij profili të profesionit/shkallës së kualifikimit, që e keni ju, sepse Agjencisë mund t'i besohen disa punë nga ana e Shërbimit Kombëtar për Punësim.



POLICIA

Administrata policore është kompetente për rregullimin e dokumenteve tuaja personale: letërnjoftimit, ndonjëherë edhe nënshetësisë, pasaportës, regjistrimin e vendbanimit, regjistrimin e vendqëndrimit.

Administratat policore mbulojnë territore më të mëdha, ndërsa çdo bashkësi lokale, komunë, dhe ndonjë vend në komunë, kanë stacione policore apo zyra të policisë.

Të gjitha punët për qytetarët do t'i bëni në administratën policore apo stacion policor, ku do të merrni edhe informacionet rreth dokumentacionit të nevojshëm për rregullimin e çdo dokumenti, si dhe rreth shpenzimeve – taksave, për të cilat ju duhet të siguroni të holla.



Organizatave humanitare dhe shoqatat e qytetarëve

Çdo komunë në Serbi e ka **Kryqin e Kuq**, një organizatë humanitare në të cilën mund të drejtoheni dhe të kërkonti informata apo mbështetje praktike.

Në shumicën e vetëqeverisjeve lokale, ekzistojnë **shoqatat e qytetarëve** (organizatat joqeveritare) që i ofrojnë mbështetje bashkëqytetarëve të rrezikuar. Ndonjëherë kjo mbështetje është këshillëdhënëse, ndonjëherë juridike e ndonjëherë edhe mbështetje praktike, materiale. Pyetni se cilat shoqata janë aktive në qytetin tuaj dhe çfarë programe ofrojnë.

Në Serbi ekzistojnë edhe organizata që ofrojnë mbështetje juridike apo këshillëdhënëse për personat e kthyer dhe mund t'i kontaktoni ato edhe kur nuk gjenden në vendin tuaj të qëndrimit dhe të merrni informacione. Shihni në adresar kontaktet e organizatave siç janë: Praxis, EHO dhe Grupi 484.

INSTITUCIONET MË TË RËNDËSISHME

Nga informacionet e paraqitura në pjesën e parë të këtij Informatori, e keni të qartë që pothuajse të gjitha të drejtat tuaja, të gjithë shërbimet, mbështetjet dhe beneficionet i realizoni në institucionet që gjenden në komunitetin tuaj lokal. Megjithatë, është e dobishme që të keni edhe kontaktet e institucioneve kompetente republikane si dhe të disa organizatave joqeveritare që në mënyrë të detajuar merren me të drejtat e personave të kthyer në Serbi. Në adresar gjenden edhe kontaktet e telefonave të mbështetjeve të ndryshme psikologjike që funksionojnë në nivel kombëtar: për fëmijët, për prindërit, për gratë viktime të dhunës familjare.

Komisariati për refugjatë dhe migrim i Republikës së Serbisë (KIRS)

Narodnih Heroja 4

11070 Novi Beograd

Telefoni: +381 (0)11 311 72 72

Zyra për Ripranim

në aeroportin "Nikola Tesla", Beograd

011/2097879

Ministria për punë, punësim, çështje sociale dhe të luftëtarëve

Nemanjina 22-26, Beograd

Telefonat kujdestar të Info-qendrës:

Mbrojtja sociale dhe familjare-juridike 011/303-86-61

Personat me invaliditet dhe mbrojtja e luftëtarëve dhe invalidëve 011/303-86-77

Dhuna në familje 011/303-86-61

Puna dhe inspektorati i punës 011/303-86-77

Sigurimi pensional dhe invalidor 011/334-78-09

Ministria e Arsimit, Agjencia për Kualifikim

Majke Jevrosime 51, Beograd, agencija@azk.gov.rs

+381 11 3345 740 Nemanjina 22-26, Beograd

011/3615043

Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Serbisë

Nemanjina 22-26, Beograd

011/361-6632

Organizata humanitare ekumenike EHO

Ćirila i Metodija 21, Novi Sad

021 466588

www.ehons.org

Grupi 484

Pukovnika Bacića 3, Beograd 116517

011 266-0972

Email:office@grupa484.org.rs

www.grupa484.org.rs

Praxis Beograd

11000 Beograd, Serbi

bgoffice@praxis.org.rs

+381 63 111 7019, +381 63 111 7029

Praxis Kraljevo

Hajduk Veljkova 2/29

36000 Kraljevo, Serbi

kvoffice@praxis.org.rs

+381 36 319 710, +381 63 111 7024

Qendra Informative për të moshuarit

Qendra gerontologjike, Kraljice Natalije 52

0800 115 116

infocentar@ugcb.rs

Telefoni i prindërve

0800 007 000

SOS Linja e fëmijëve “Numri për problemin tuaj”

0800-123456





SOS numri i telefonit dedikuar viktimave të dhunës familjare

0800-222-003

011/2647281

SOS numri i telefonit për gratë me përvojë me dhunën - Shoqata “Qendra rome për gra dhe fëmijë DAJE”

0800/002007

SOS numri kombëtar i telefonit Shoqata “Astra - aksion kundër tregtisë me njerëz”

011/785 0001

0800/101 201

SOS numri kombëtar i telefonit Shoqata e qytetareve “Qendra autonome e grave”

011/2687 190

0800/100 007

SOS numri kombëtar i telefonit Lidhja e shoqatave “Rrjeti SOS Vojvodina” Kikinda

0230/437 343

0800/101 010

SOS numri i telefonit për gratë me përvojë me dhunën - SOS numri kombëtar i telefonit SHQ Këshilli për të Drejtat e Njeriut Vranjë

017/410822

0800/001017

Caritas Serbia - Këshillimorja për personat e kthyer

Vojvode Stepe 78/lok. 5, 11000 Beograd 011/4099561



/ADRESARI

SUBOTICA	25
SREMSKA MITROVICA	27
MALI IDOŠ	29
KOVAČICA	31
BABUŠNICA	33
BEČEJ	34
KULA	37
NOVI SAD	39
VLADIČIN HAN	44
TITEL	46
KRAGUJEVAC	48
VELIKA PLANA	51
LEBANE	53
BUJANOVAC	54
BAČKA PALANKA	56
NIŠ	59
BEOGRAD	62

SUBOTICA

Kuvendi i qytetit të Suboticës , Trg Slobode 1, 24000 Subotica, www.subotica.rs, +381 24 626 888

Shërbimet e qytetit/komunës	Personi përgjegjës	Adresë/ numri i zyrës	Numri i telefonit / adresa e emailit
Adresa/numri i zyrës	Numri i telefonit/email adresa	Trg Slobode 1	024/ 626 888 gunacelnik@subotica.rs
Administrata e qytetit	Marija Ušumović Davčik kreu i administratës së qytetit	Trg Slobode 1	024/626-999 SMS-a na broj: 069/626-999 kontaktcentar@subotica.rs
Qendra e shërbimit/qendra e kontaktit 024/pyetje dhe raporte të problemeve nga të gjitha fushat në kompetencën e vetëqeverisjes lokale		Trg Slobode 1	gusefdrustvene@subotica.rs 024/626-849
Sekretariati për aktivitetet sociale	Jasmina Stevanović, sekretare	Trg Slobode 1	024/626-933 gordana.vidakovic@subotica.rs
Shërbimi për veteranë-mbrojtja e aftësive të kufizuara dhe kujdesi social për fëmijë	Gordana Vidaković, shef i shërbimit	Trg Republike 16	024 /666301
Shërbimi i planifikimit urban dhe çështja e strehimit	Petar Radovanović	Tuk Ugarnice bb	024/415-0031 024/415-0030
Qendra e pranimit për emigrantët	Siniša Marković, menaxher i qendrës së pritjes së emigrantëve	Trg slobode 1	024/626 971
Komisioni/Këshilli për Refugjatë dhe Migrim	Renata Babić	Trg slobode 1	024/ 626923 magda.fehervari@subotica.rs
Ekipi mobilizues për përfshirjen e romëve	Magda Fehervari, Zëvendës sekretari i Sekretariatit për aktivitetet sociale GU Suboticë	Nova Opština, Trg Lazara Nešića 1, 10 sprat	024 /641 104 stevannikolic@yahoo.com
Koordinator për çështjen e romëve	1. Stevan Nikolić 2. Klaudija Kurina	Trg slobode 1, (I/135),	024/626-898 ombudsman@subotica.rs
Mbrojtës i qytetarëve	Erika Tot Salai, avokat i diplomuar.	Trg slobode 1, (II/238-4)	024/626-882 branko.vitasovic@subotica.rs

MBROJTJA SOCIALE

Institucion	Adresë	Numri i telefonit / adresa e emailit	
Qendra për punë sociale	Šantićeva br. 27	024/548-220 centarsubotica@csrsu.org.rs	
SHËRBIMET E KOMUNITETIT			
Shërbim	Shërbimet	Adresë	Numri i telefonit / adresa e emailit
Ndihmë në shtëpi për të rriturit dhe të moshuarit	Caritas	ul. Zmaj Jovina br. 20	024-559-139 caritas@tippnet.rs
Ndihmë në shtëpi për të rriturit dhe të moshuarit	Qendra Gerontologjike	ul. Žarka Zrenjanina br. 16	024/644-444 gerontoc@gcsu.rs
DB për fëmijë/të rinj me aftësi të kufizuara	Instituti për strehimin e fëmijëve dhe të rinjve Kolevka	Ulica Jaše Ignjatovića	024/ 552-468, 552-335
Kujdesi ditor për të rriturit me aftësi të kufizuara	Instituti për akomodimin/strehimin e fëmijëve dhe të rinjve Kolevka	Banijska 65	064 847 3061
Shoqërues personal	informimi rreth kushteve dhe mundësive të ofruara në Qendrën për Punë Sociale	Šantićeva br. 27	024/548-220 centarsubotica@csrsu.org.rs
Ndihma personale	informimi rreth kushteve dhe mundësive të ofruara në Qendrën për Punë Sociale	Šantićeva br. 27	024/548-220 centarsubotica@csrsu.org.rs
Strehë për fëmijë	Institucioni për akomodimin e fëmijëve dhe të rinjve Kolevka	Ulica Jaše Ignjatovića	024/552-468, 552-335
Këshillimi –Qendra e Këshillimit dhe mbështetjes familjare	Në Qendrën për Punë Sociale	Šantićeva 27/I	024/ 551-619 savetovaliste@csrsu.org.rs

ARSIMI

Lloji i institucionit	Emri i institucionit	Adresë	Numri i telefonit / adresa e emailit
Institucioni Qendror Parashkollor	Institucioni Parashkollor "Naša radost"	Matije Cupca 31, Subotica	024/646-411
Instituti parashkollor (PU) „Naša radost“ ka 54 objekte në komunën e Suboticës dhe angazhon 2 asistentë pedagogjikë			
Shkolla për edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara (shkolla speciale)	1.Shkolla fillore dhe e mesme „ŽarkoZrenjanin“ 2.Qendra shkollore për arsimim dhe edukim të personave me demtim të dëgjimit „Dositej Obradović“	1.Ivana Gorana Kovačića 14 2. Zrinjskog i Frankopana 2	1. 024/553-037 zarkozre@eunet.rs 2. 024/556-119 024/527-449; skcentar@tippnet.rs
Shkollat që kanë një asistent pedagogjik për studentët romë	1. SHF "Hunjadi Janoš" - Čantavir (Suboticë) 2. „Matko Vuković“ Suboticë 3. „Sečenji lštvan“, Suboticë	1. Trg slobode 2, Čantavir 2. Adresë :Rudera Boškovića 1 3. Karadordev put 94	1.024/782-025 suli@tippnet.rs 2. 024/456-25-73 osmatkov_su@mts.rs 3. 024/525-799 office@secenji.edu.rs
Shkolla e edukimit të të rriturve dhe Shansi i dytë	SHF „Jovan Jovanović Zmaj“	Trg cara Jovana Nenada 15 (Zgrada Otvorenog Univerziteta)	024 /556-735
Administrimi kompetent i shkollës	SHU Sombor	Trg Cara Uroša 1	025/ 463634
Në komunën e Suboticës janë 24 shkolla fillore. Përvec Suboticës, shkollat fillore në këtë komunë janë të vendosura edhe në këto vende: Novi Žednik, Čantavir, Tavankut, Palić, Hajdukovo, Stari Žednik, Đurđin i Bajmok.			

SISTEMI SHËNDETSOR

Shërbim	Insitutet	Adresë	Numri i telefonit / adresa e emailit
Këshillim zhvillimor	Shtëpia e shëndetit	Đure Đakovića 14	024/ 536 136
Këshillimi për të rinj	Shtëpia e shëndetit	Đure Đakovića 14	024/ 536 136
Ndërmjetës shëndetsor Ljubinka Gluščević	Shtëpia e shëndetit	Đure Đakovića 14 patronazna služba	024/552-791
Dega e Institutit të Republikës për sigurim shëndetësor	Enti Republikan për sigurimet shëndetësore	Trg slobode 3 , Subotica	024/554-444 Fax: 024/558-473

TREGU I PUNËS

Institucioni/organizata	Adresë	Numri i telefonit / adresa e emailit
Dega e Shërbimit Kombëtar të punësimit (Byroja e Punësimit)	Jovana Mikića 12, Subotica,	024/644-600
Agjensionet e punësimit 1.Infostood 3 2.Uspinjača posao doo 3. WNC doo 4. Via-job doo	1. Vladimira Nazora 3 2. Maksima Gorkog 23 3.Matije Korvina 18 4. Matije Korvina 2	1. 024/4155 628 2. 024/539 162 sanda@employment.power.com 3. 024/556-034 Szabopinter.Egon@whc.hu 4.024/536-558, 064/14-85-183, livija81@gmail.com
Klubi i kërkimit të punës për degët e shërbimit kombëtar të punësimit	Jovana Mikića 12	024/644-600 jovica.batas@nsz.gov.rs nszsu@open.telekom.rs

DEPARTAMENTI I POLICISË

Institucioni/organizata	Adresë	Numri i telefonit
Departamenti i policisë	Segedinski put 45, 24000 Subotica	024/ 630 200
Qendra e Stacionit Policor	Park Rajhl Ferenc 1, 24000 Subotica	024/ 556 238

STREHIMI SOCIAL

Qyteti I Suboticës është në proces të ndërtimit të banesave sociale.

ORGANIZATAT HUMANITARE DHE JO-QEVERITARE RELEVANTE PËR NEVOJAT E KTHIMIT

Organizata	personi përgjegjës	Adresë	Numri i telefonit / adresa e emailit
1.Kryqi i Kuq	dr Siniša Trajković, sekretar i kryqit të Kuq Suboticë	Trg žrtava fašizma 3, 24000 Subotica	024 621 101, http://www.suredcross.org.rs subotica@redcross.org.rs
2.EHO	Nada Dimović - Bashkëpunor i integritit lokal	/	nadadimovic@yahoo.com
3.Fondacioni Higjiena Mendore "Exspecto"	Drejtor: Jo Horti Livija	Alekse Šantića 27, Subotica	Tel/Faks: 687-620, 687-621 www.exspecto.org.rs exspecto@gmail.com , fondacijaexspecto@gmail.com
5. Caritas	President: Vič. Paskó Csaba Drejtor: Gabor Ric	Zmaj Jovina 20, Subotica	Telefon/fax: +381-24-559-139 caritas@tippnet.rs www.caritas-su.org.rs
6. UG „Edukativni Centar Roma“	Stevan Nikolić	Somborski put 60 , Subotica	024 554 697 Fb Edukativni centar Roma stevannikolic@yahoo.com nadadimovic@yahoo.com

SREMSKA MITROVICA

Asamblea Komunale, Sv.Dimitrija 13, 22000 Sremska Mitrovica, +381 22-610 - 566

Shërbimet e qytetit/komunës	Personi përgjegjës	Adresë/ numri i zyrës	Numri i telefonit / adresa e emailit
Departamenti/ Sekretariati për aktivitete Sociale	Miroslav Jokić	Sv.Dimitrija 13, br. 32	022/610-261, guprava5@sremskamitrovica.org.rs uprava5@sremskamitrovica.org.rs
Shërbimi për shtesat e fëmijëve	Vojislav Mirnić	Kralja Petra I 5	guprava10@sremskamitrovica.org.rs
Këshilli shëndetësorë	Živko Vrcelj	Stari šor 65	022/610-222
Shërbimi I planifikimit urban dhe strehimit	Vesna Vujanović	Sv.Dimitrija 13, br.37	022/610-559, 022/2152088 osm_uprava6@ptt.rs
Komisioni/ Këshilli i refugjatëve dhe migracionit	Tomislav Janković	Svetog Dimitrija 13	022/610- 572

MBROJTJA SOCIAE

Institucion	Adresë	Numri i telefonit / adresa e emailit
Qendra për punë sociale	Promenada 9	022/623-379,022/623-389; direktor@csrsavasm.org.rs

SHËRBIMET E KOMUNITETIT

Shënim: Për të gjitha shërbimet e mbrojtjes sociale dhe referime përgjegjëse është Qendra për punë Sociale.

Shërbimet	Shërbim	Adresë	Numri i telefonit / adresa e emailit
Ndihmë në shtëpi për të rriturit dhe te moshuarit	Qendra për punë sociale	Promenada 9	022/623 - 389
Qëndrim ditorë për fëmijët/të rinj me aftësi të kufizuara	ŠOSO „Radivoj Popović“(Qëndresa ditore “Sunce”)	Fruškogorska 65	022/639 -085 skolarp@open.telekom.rs
Kujdesi ditor për te rriturit me aftësi të kufizuara	Qendra ditore për persona me aftësi të kufizuara “Sveta Tereza” Caritas	Timočke divizije 62	063/1173005
Shoqërues personal	ŠOSO „Radivoj Popović“	Fruškogorska 65	022/639- 085
Mbështetje strehimi për të rinjtë që largohen nga sistemi i mbrojtjes sociale	Qendra për punë sociale	Promenada 9	022/623 -389
Strehim për viktimat e dhunës	Qendra për punë sociale	Promenada 9	022/623 -389
Këshillimet	Qendra për punë sociale	Promenada 9	022/623 -389

ARSIMI

Tip ustanove???	Naziv	Adresë	Numri i telefonit / adresa e emailit
PU Qendrore për të gjitha kopshtet	"Pčelica", objekti Zvezdica	Marko Peričin Kamenjar 16	022/624398
Shkollat që kanë programe për të mbështetur fëmijët dhe familjet nga ana sociale me disavantazh financiar	1."Dobrosav Radosavljević Narod" 2."Triva Vitasović Lebarnik"	1.Mačvanska Mitrovica, Mačvanski kej 6p.29 2. Lačarak, 1.Novembar 221	1. 022/651820 osdrnmm@hotmail.com 2. 022/670585 sm.ostvl@open.telekom.rs
Shkollat për edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara (shkolla special)	ŠOSO „Radivoj Popović“	Fruškogorska 65	022/639 -085 skolarp@open.telekom.rs
Shkollat që kanë një asistent pedagogjik për studentët te komunitetit romë	"Triva Vitasović Lebarnik"	Lačarak, 1.Novembar 221	022/670585 sm.ostvl@open.telekom.rs
Administrim kompetent i shkollës	Administrata e shkollës Novi Sad	Bulevar Muhajla Pupina 6/4, Novi Sad	021/529223

Në komunën e Sremska Mitrovicës janë nëntë shkolla fillore. Përveq Sremska Mitrovicës, shkollat fillore në këtë komunë janë të vendosura edhe në këto vende: Kuzmin, Mačvanska Mitrovica, Martinci dhe Lačarak. Institucioni parashkollor (IP) ka nëntë ambiente në komunë

SISTEMI SHËNDETËSOR

Shërbim	Institucion	Adresë	Numri i telefonit / adresa e emailit
Këshilli i zhvillimit	Shtëpia e shëndetit	Jupiterova bb, Dom zdravlja Sremska Mitrovica	022/610-222, 064/8-770-618 Lok 263
Këshilli për të rinj	Shtëpia e shëndetit	Jupiterova bb, Dom zdravlja	022/610-222, Lokal 105
Dega e institutit të sigurimeve shëndetësore të republikës	Instituti republikan për sigurimet shëndetësore	Svetog Dimitrija 4,	022/600-200

TREGU I PUNËS

Institucioni/organizata	Adresë/ numri i zyrës	Numri i telefonit / adresa e emailit
Dega e shërbimit kombëtar të punësimit (zyra e punësimit)	Svetog Dimitrija 31	022/638-801
Klubi i kërkimit të punës NSZ	Svetog Dimitrija 31	022/638-806, biljana.jakovljevic@nsz.gov.rs
Agjensionet e punësimit "Sirmzard"	Ratarska 17	022/618140, oz.sirmzard@gmail.com

DEPARTAMENTI I POLICISË

Institucioni/organizata	Adresë	Numri i telefonit
Stacioni policor	Trg Čire Milekića 1	022/610 270



ORGANIZATAT HUMANITARE DHE JO-QEVERITARE RELEVANTE PËR NEVOJAT E KTHIMIT

Organizata	Personi përgjegjës	Adresë	Numri i telefonit / adresa e emailit
